



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.:

4/460

Datë:

18/11/2022

DEKLARATË E KËSHILLIT DREJTUES

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", me një traditë të gjatë dhe me një prestigj në kuadër të zhvillimeve të mëtejme në përmirësimin e performancës, konform kërkesave të kohës ka nevojë për veprimet e menjëhershme, si në vijim:

- 1. Hartimi i Strategjisë 2023-2025:** Fuqizimi i vlerës së dokumentit të strategjisë duke e mbështetur me mekanizma të llogaridhënies, me fokus në ngritjen e cilësisë së programeve, zhvillimin e mëtutjeshëm të shkencës dhe zhvillimin e studentëve dhe personelit akademik.
- 2. Statuti i UP-së:** Plotësim ndryshimi i Statutit të UP-së, me qëllim të përditësimit dhe avancimit apo edhe ndryshimeve konform kërkesave krahasuar me Universitetet dhe më gjerë. Së bashku me ndryshimet në Statut do të rishikohet edhe riorganizimi i brendshëm i Universitetit duke adoptuar praktikë më të përshtatshme për Universitetin, përfshirë kriteret për përfaqësimin në të gjithë trupat akademike në Universitet.
- 3. Hapja e Universitetit:** Rishikimi i qasjes së tanishme për mbulimin e lëndëve dhe orëve të mësimi dhe krijimi i një sistemi të drejtë e cilësor me tendencë të qartë për hapjen e Universitetit për staf akademik të mirë përgatitur, duke aplikuar një reformë për rekrutimin e kandidatëve konkurrues më meritore vendorë dhe të atyre që kanë studiuar apo janë profesorë në universitetet ndërkombëtare.
- 4. Studenti në qendër:** Rritja e përfshirjes së studentëve në të gjitha hallkat e zhvillimit të Universitetit dhe krijimi i mundësive për praktikat profesionale në kuadër të bashkëpunimeve me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, përherë në rritjen e aktiviteteve për studentë dhe përgatitjen për tregun e punës. Rishikimi i dokumenteve themelore për të shtuar përfaqësimin e studentëve në udhëheqje e në menaxhim, në përputhje me treguesit dhe dispozitat përkatëse të Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (ZEAL).
- 5. Rritja e Integritetit Akademik:** Ristrukturimi i politikave të Etikës dhe Disiplinës. Adresimi i çështjes së plagjiaturës duke krijuar infrastrukturën juridike dhe teknike përkatëse, mekanizmat e parandalimit, kontrollit dhe ndëshkimit.
- 6. Bashkëpunimi me palën e tretë (Bashkëpunimi me ekonominë):** Funkcionalizimi i instituteve në kuadër të njësive akademike apo edhe të pavarura me qëllim të rritjes së të hyrave vetanake në rritjen e buxhetit të UP-së, si dhe rritjes së performancës së nivelit të pajisjeve laboratorike dhe rritjes së performancës së stafit akademik dhe studentëve. Rishikimi dhe përditësimi i Rregullores për themelimin dhe parimet e funksionimit të instituteve në Universitetin e Prishtinës, për të larguar barrierat financiare që kanë shërbyer si bllokadë deri tani.

7. **Digjitalizimi:** Ndarja e veçantë e buxhetit për kryerjen e transformimeve digjitale të nevojshme në Universitet, duke u bazuar mbi praktikën më të mirë perëndimore në fushën e digjitalizimit në arsimin e lartë. Rritja e performancës së digjitalizimit të sistemeve aktuale dhe plotësimi sipas nevojave, me theks të veçantë në platformat për detektimin e plagjiarizmit.
8. **Ndërkombëtarizimi:** Rritja e bashkëpunimeve me universitetet me renome ndërkombëtare. Krijimi i programeve në gjuhë të huaja që mundësojnë njohjen e dyfishtë të diplomave (Double Degree). Koordinim dhe pjesëmarrje në programe ndërkombëtare të mobilitetit për kërkuesit shkencor, stafin akademik, administrativ dhe për studentët.

Këshilli Drejtues i UP-së

